



Planuar / Doretuar Priljenoi/Prodato Received/Duilty	24.05	2023	3	viti god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSAC	4404/2023		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.639/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.639/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër Vendimit KD.Nr.016/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.639/2023 e datës 14.04.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.016/2023 i datës 03.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Komisioni prej tre anëtarëve më datë 20.03.2023 është përgatitur raport i nxjerrjes së çelësave jashtë institucionit për Zëvendësuesin e Qendrës së Paraburgimit në Prizren, ku në bazë të tij është gjetur se më datë 18.03.2023 Mbikëqyrësi pas përfundimit të detyrës në orën 19:00 ka marr me vete grumbullin e çelësave të mbikëqyrësit në pjesën banuese derisa ankuesi si zëvendësues i Mbikëqyrësit të Lartë ka nënshkruar se çelësat janë kontrolluar dhe nuk ka konstatuar mungesën e çelësave, dhe në bazë të raportit është konstatuar se ankuesi ka bërë

shkelje të rënda disiplinore pas që me veprimet apo mos veprimet e tij ka ra ndesh me Instruksionin e Drejtorit Nr. 05/22 të rishikuar më datës 14.05.2022.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren më datë 20.03.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. 2320/23 për inicimin e procedurës disiplinor pranë Komisionit Disiplinor ndaj të zyrtarëve në mesin e tyre edhe ankuesit i cili është i punësuar në pozitën *Mbikëqyrës* në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 03.04.2023 ka nxjerr Vendim KD.nr.16/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelej të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi i 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj"*.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 12.04.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 14.04.2023 dhe është protokolluar me numër 3562/2023, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikim i gabuar i dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 24.04.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 02.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3562/2023 të datës 14.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.016/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimit KD.Nr.003/2022 të datës 24.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Raporti i nxjerrjes së çelësave jashtë institucionit i datës 20.03.2023; Formularin e kontrollimit të çelësave i datës 02.04.2023; Raport nga konsulta mjekësore për aneksin i datës 03.04.2023; Kërkesë e datës 05.04.2023 nga ankuesi; Informatën me Nr. 345/23 e datës 18.03.2023 nga Informatën e datës 21.03.2023 nga Deklaratën me Nr. 349/23 e datës 19.03.2023 na Detyrat e punës më datë 18.03.2023; Pranim dorëzimi i detyrës më datë 18.03.2023; Informatën e datës 18.03.2023; Informatën e datës 19.03.2023; Formulari i kontrollimit të çelësave i datës 18.03.2023; Kontratë pune për kohë të caktuar e datë 30.06.2018 për ankuesin; Zarfin e datës 12.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.04.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.05.2023; Kërkesë me Nr. 2320/23 e datës 02.03.2023 për inicimin e procedurës disiplinore; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i darës 30.03.2023; Ftesë për intervistë e datës 27.03.2023; Informatën me Nr. 344/23 e datës 18.03.023 e ankuesit; Informatën me Nr. 384/23 e datës 19.03.2023 nga Instruksionet e Drejtorit për Stafin e Qendrës së Paraburgimit në Prizren me numër reference 05/2022 të datës 14.05.2022 dhe me numër reference 12/2022 e datës 14.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e *pa bazuar, sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.016/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që ky vendim është nxjerr me shkelje procedurale dhe materiale sepse unë nuk kam përgjegjësi për shkak që mbikëqyrësi i pjesës së banimit nuk ka dorëzuar çelësat tek unë por i ka marr me vete ndërsa përgjegjës për çelësa është zyrtar . ndërsa i njëjti më ka lajthitur si epror të tij,, ndërsa që i njëjti është liruar nga përgjegjësia. Masa disiplinore ndaj meje është subjektive dhe e paligjshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se më datë 18.03.2023 gjatë ndërrimit në bazë të Formularit të Kontrollimit të Çelësave nga ora 07:00 deri në orën 19:00 është konstatuar se të gjithë zyrtarët që kanë pranuar detyrën nga zyrtarët e tjerë janë nënshkruar që të gjithë çelësat janë kontrolluar dhe nuk është vërejtur ndonjë mungesë, mirëpo gjatë ndërrimit në orën 19:00 zyrtar ka dorëzuar detyrën tek ankuesi ku ky i fundit në Formularin e Kontrollimit të Çelësave ka nënshkruar që të gjithë çelësat janë kontrolluar dhe nuk është vërejtur ndonjë mungesë, mirëpo që në bazë të raportin e nxjerrjes së çelësave jashtë institucionit të datës 20.03.2023 në të cilin ku është gjetur se në kohën e ndërrimit më datë 18.03.2023 në orën 19:00 është pranuar detyra mirë çelësat nuk kanë qenë edhe pse është evidentuar që çelat nuk mungojnë.

Për të konstatuar në mënyrë të drejtë se a qëndrojnë pretendimet si në raportin e datës 20.03.2023, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar provat e lëndës, informata dhe deklaratat e ankuesit dhe zyrtareve të tjerë, respektivisht informatën me Nr. 344/23 të datës 18.03.2023 të ankuesit drejtuar zëvendësuesit të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren ku thekson se : *"më datë 18.03.2023 në orën 19:00 mbikëqyrësi i ka harruar qelsa e mbikëqyrësve në gjep dhe i ka marr me vete. Pasi është vërtitur se mungojnë e kam thirr mbikëqyrësin se mos i ka harruar në gjep dhe ka marr me vete. Qelsat i solli në institucion në orën 02:10 minuta dhe për këtë e ka njoftuar Udhëheqësin e Sigurimit dhe po ashtu e kam thirrur edhe drejtorin ,njëherit është përpiluar informata".* Në bazë të deklaratës me Nr. 349/23 të datës 19.03.2023 mbikëqyrës

ka deklaruar: *"Se qelsat e mbikëqyrësve kanë qenë në gjep të jaknes dhe mas përfundimit të punë kam shku në shpi me qelsat në gjep, rreth orës 02:00 mbikëqyrësi më ka thirr me telefon tu i lyp qelsat dhe për 15 minuta kam ardhë në qendër dhe i kam pru qelsat dhe të dera ka dal ".* Zyrtar Korrektues në bazë të informatës me Nr. 345/23 të datës 18.03.2023 deklaroi: *" Se pas ndërrimit të orës 19:00 i ka harruar qelsat dhe i ka marr me vetë pastaj mbikëqyrë e ka thirr ne telefon mbikëqyrësin dhe i njëjti i ka sjell qelsat në orën 02:10 për këtë ishte informuar udhëheqësi i sigurimit ",* ndërsa Mbikëqyrës i Lartë në bazë të informatës me Nr. 384/23 të datës 19.03.2023 deklaroi: *" se rreth orës 17:00 është bërë kontrolli qelsave në dhomën e kontrollit dhe kam shënuar në formularin e kontrollimit të qelsave që është vërtetuar se nuk kishte vërejtje. Në orën 19:00 detyrën ja kam dorëzue mbikëqyrësi të pjesës së banimit i cili ka insistue në*

numërimin e të burgosurve ndërsa unë kam bërë bastisjen e stafit gjatë hyrjes dhe daljes, Telefonin zyrtar dhe qelsat e mbikëqyrësit të lartë ja kam dorëzue mbikëqyrësi

Kolegji i Këshillit, bazuar në informata, deklaratat e sipërcekura si dhe deklarimeve të ankuesit në seancë të Komisionit Disiplinor të datës 30.03.2023, ka konstatuar se ankuesi me rastin e pranimit të detyrës më datë 18.03.2023 në orën 19:00, ka nënshkruar se të gjithë çelësat janë kontrolluar dhe nuk është vërejtur ndonjë mungesë edhe pse në bazë të provave çelësat nuk kanë qenë në vendin e tyre, si rrjedhojë ankuesi gjatë pranimit të detyrës nuk ka evidentuar nëse çelësat janë në vendin e tyre, me këtë rast nuk është vepruar sipas Instruksioneve të Drejtorit për Stafin në Qendrën e Paraburgimit në Prizren me numër reference nr.05/2022 të datës 14.05.2022 dhe me numër reference nr. 12/2022 të datës 14.05.2022 të nënshkruar nga zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, përmes të cilëve i gjithë stafi janë të obliguar që të sigurohet se të gjithë çelësat janë kthyer dhe janë në numër të saktë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se veprimi i ankuesi pa u evidentuar nëse çelësat janë në vendin e tyre dhe janë dorëzuar nga zyrtari nga i cili ka marr detyrën, përveç që bien ndesh me instruksionet e cekura si më lartë, ky veprim i ankuesi bie ndesh me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", sepse zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, siç parashihet me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase ankuesi me veprimin e tij duke mos respektuar procedurat e brenda të institucionit dhe dispozitat përkatëse ligjore në fuqi ka bërë moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale duke bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë

Kolegji lidhur me ligjshmërinë e Vendimit KD.Nr.016/2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstaton se ky vendim ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor", rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e



Përgjithshme Administrative, dhe në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit, janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.639/2023, datë 24/05/2023.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.